

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2020

## NJOFTIM

Për mbledhjen Nr. 21, datë 22.05.2020, ora 10:00  
të Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 22.05.2020, ora 10:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 21 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

1- Mbi kërkesën e shoqërisë “MP-Hec” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.04.2020 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 25.11.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “MP-Hec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Niçë” me kapacitet të instaluar 2270 kW”

2- Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a, për barrësim të aseteve të luajtshme (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019” dhe Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE  
Petrit AHMETI